



ДРЖАВЕН ЗАВОД ЗА РЕВИЗИЈА
ENTI SHTETËROR I REVIZIONIT
STATE AUDIT OFFICE

Број:

Дара:

ENTI SHTETËROR I REVIZIONIT

- Njoftim për mediumet -

Shkup 09.03.2023

Të pathënat juridike për mbështetjen e inovacioneve

Është e nevojshme përsosja e programeve për punën e FIZHT me indikator vlerësues sipas instrumentit, në kuadër të mjeteve të aprovuara buxhetore dhe vendosjes së bazës së centralizuar me të dhëna për mbështetjen financiare

Enti Shtetëror i Revizionit ka kryer revizion të pajtueshmërisë me temë „**Mbështetje financiare (grante kofinanciare) për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme për inovacion dhe zhvillim teknologjik**” të Fondi për inovacion dhe zhvillim teknologjik në pajtim me Programin Vjetor të Punës për vitin 2022 për periudhën 2019 - 2021.

Me revizionin e kryer janë konstatuar aktivitete të padefinuara dhe mosharmonizim me aktet normative, strategjike dhe politikat e përcaktuara nga aktiviteti inovativ, përkatësisht:

- **nuk është kryer azhurnimi** i Statutit të FIZHT me ndryshimet e rregullativës ligjore, të cilat **rregullojnë** kompetencat dhe periudhën e angazhimit të Këshillit Drejtues, detyrimet dhe përgjegjësitë e drejtorit, mandatin e Komitetit për aprovimin e investimeve, afatin e miratimit të vendimit nga ana e Komitetit, mënyrën e përcaktimit të kompensimeve të Komitetit dhe etj. gjendje e cila udhëzon në **përpëasje të akteve të miratuara** me dispozitat e Ligjit për veprimtari inovative;
- **zbatim të aktiviteteve** nga ana e FIZHT, të cilat **nuk janë definuar në Ligjin për veprimtari inovative dhe nuk janë të harmonizuara me Strategjinë për inovacion 2012-2020**, ndërsa janë ndarë me Planin e Qeverisë së RMV-së për rritje ekonomike, për të cilat janë lidhur marrëveshje për ndarjen e mjeteve në shumë prej **rreth 596 milion denarë**;

- **realizimi jo i plotë** i masave dhe aktiviteteve të përcaktuara me **Strategjinë për inovacion të RMV-së 2012-2020 dhe Planeve të Veprimit për periudhën 2013-2015, 2016-2018 dhe 2019-2020**. Përkatësisht, në kompetencat e FIZHT janë përcaktuar **16 masa**, prej të cilëve **7 shtatë masa nuk janë realizuar**;
- **mungesë e Strategjisë për specializim të zgjuar**, dhe rrjedhimisht nuk është siguruar vazhdimësi e aktiviteteve në veprimtarinë inovative edhe pas vitit 2020, dokumentet strategjik i cili ka ndikim në krijimin dhe realizimin e politikave në fushën e inovacionit, gjegjësisht sigurim i qasjes moderne për zhvillim ekonomik, nëpërmjet ndërlidhjes së komunitetit akademike, sektorit afarist, institucionet qeveritare dhe sektorit qytetarë për zbulimin dhe veprimin e përbashkët në fushat në të cilat shteti ka potencial më të madhe dhe resurse të mjaftueshme për të investuar;
- në aktet **nuk është përcaktuar afati për lidhjen e marrëveshjeve**, ndërsa shfrytëzuesit nuk i dorëzojnë në kohë raportet tremujore dhe raportin përfundimtar për aktivitete e zbatuara më parë.

Është konstatuar nevoja për përsosje të **programeve për punë të FIZHT** me indikatorët vlerësues sipas instrumentit në kuadër të mjeteve të aprovuara buxhetore dhe **vendosjen e bazës së centralizuar** me të dhëna për ndarjen e mbështetjes financiare.

Gjithashtu është konstatuar se **Programet Vjetore të Punës për periudhën 2019-2021 nuk përmbajnë indikator financiar** për mbështetjen e planifikuar financiare sipas instrumenteve të veçanta dhe **nuk sigurojnë të dhëna** sa nga mjetet janë dedikuar për zbatimin e masave dhe instrumenteve nga viti aktual, dhe sa janë dedikuar për pagesën e detyrimeve të transferuara nga vitet e kaluara.

Me analizën e kryer të **akteve për sistematizim dhe organizim të vendeve të punës**, me revizionin janë konstatuar se të njëjtit **nuk përputhen me kompetencat, rendësin dhe madhësinë e punës** së FIZHT, gjegjësisht **nga sistematizimi i 16 vendeve të punës, janë plotësuar vetëm 8**.

Për shkak të **vëllimit të punës** si rezultat i ndryshimeve ligjor, rritjes së buxhetit, orientimeve programore dhe strategjike të zgjeruara të FIZHT, kompetencat e **caktuara** për zbatimin e PRrE, shtylla 3, në kushte të pamjaftueshme të kapaciteteve administrative, FIZHT **vazhdimisht angazhon persona të jashtëm** të cilët kryejnë detyrat e punës lidhur me veprimtarinë, për të cilat në **periudhën 2019-2021 janë paguar** mjete **në shumë prej rreth 46 milion denarë**.

Viti	2019	2020	2021
Persona të angazhuar me kontratë në vepër-angazhim i vazhdueshëm	38	45	50
Mjetet e paguara për kontratë në vepër-angazhim i vazhdueshëm (në 000 denarë)	7.544	13.384	19.377
Persona të angazhuar me kontratë në vepër-bashkëpunëtor të jashtëm	16	15	18

Mjetet e paguara për kontratë në vepër-bashkëpunëtor të jashtëm (në 000 dena rë)	1.746	2277	1.472
--	-------	------	-------

Revizorët vlerësojnë se angazhimi i personave me kontratë në vepër, pavarësisht pëlqimit të dhënë nga ministria kompetente, **kontribuon në mostransparencë dhe sjellje subjektive** gjatë lidhjes së kontratës dhe përcaktimit të shpërblimit mujor për angazhimin e personave në punë të cilët në vazhdimësi janë të angazhuar në FIZHT për një periudhë më të gjatë kohore.


Sa i përket **monitorimit dhe realizimit të mbështetjes financiare** nga Plani për rritje ekonomike, shtylla 3, FIZHT në periudhën 2019-2021 nga shpalljet e thirrjeve publike ka lidhur **marrëveshje për 364 projekte**, prej të cilave deri **me datë 20.05.2022** janë realizuar **93 proekte dhe 258 projekte janë në proces vijues**.

Me kontrollin e kryer **në realizimin e thirrjeve publike** konstatoam se në Vendimet për financimet e miratuara nga Komiteti për aprovimin e investimeve **nuk është caktuar afati për lidhjen e marrëveshjeve për** ndarjen e mjeteve, ndërsa shfrytëzuesit **nuk i dorëzojnë në kohë raportet tremujore/përfundimtare për aktivitetet e realizuara më parë**, gjë që kontribuon për zgjatjen e kohës së realizimit të projekteve.

Realizimi i thirrjeve publike të lartpërmendura është paraqitur në grafikun e mëposhtëm:

Grafiku nr.1

në 000 denarë



Gjithashtu, me revizion është **konstatuar** se në periudhën 2019-2020, **FIZHT ka angazhuar ekspert** për vlerësimin dhe dhënien e mendimit profesionist të projekteve nga shpallja e thirrjeve publike për mbështetje financiare, për të cilët **janë paguar mjete** në shumën totale **prej rreth 16 milion denarë**.

FIZHT **nuk ka ndërmarrë aktivitete** për kategorizimin e eksoertëve të regjistruar në seksionet përkatëse në Regjistrin nga i cili do të përzgjidhen ekspertët sipas sistemit të rotacionit, **nuk është formuar** Komisioni për vlerësimin e ekspertëve, **nuk është miratuar akti për punën** e Komisionit dhe **nuk kryet** testimi dhe intervista për vlerësimin e ekspertëve, në bazë të së cilës do të kryet azhurnimi i listës me numra rendor të ekspertëve të regjistruar në Regjistër.

Dhënia e mbështetjes financiare është proces i kompleks, ndërsa **për monitorim dhe kontroll të realizimit të marrëveshjeve** është i nevojshëm **kuadr kompetent dhe profesionist**, të cilin FIZHT nuk e ka në dispozicion gjatë periudhës së revizionit, për çka nuk mundë t'u përgjigjet detyrimeve të përcaktuara në marrëveshjet e lidhura.

Për shkak të së theksuarës, dhe me synim të përmbushjes në kohë të detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshjet e lidhura me shfrytëzuesit, projektet e të cilëve janë aprovuar për financim, FIZHT **shpall** thirrje publik „Shërbime për menaxhim me projekte (monitorim)”. Në periudhën 2019-2021 FIZHT **ka lidhur katër marrëveshje kornizë** për prokurim të shërbimeve për menaxhim me projektet (monitorim) në shumën totale prej **rreth 101 milion denarë**.

Kontaktet për shtyp:

Albiona Mustafa Muhaxhiri +389 72228 203 albiona.mustafa@dzr.gov.mk

Mijallçe Durgutov +389 70 358 486 mijalce.durgutov@dzr.gov.mk

Martin Duvnjak +389 75 268 517 martin.duvnjak@dzr.gov.mk